VENDIM
Nr. 3, datë 13.1.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "KESH" SH.A., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK I DIGËS QYRSAQ, HEC VAU I DEJËS, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5.143 mwp

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të neneve 4, pika 1, germa "a", 5 pika 1, germa "a" dhe të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 164/5 prot., datë 29.12.2021, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'KESH' sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik i digës së Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 mwp",

konstatoi se:

- Shoqëria "KESH" sh.a. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1119 prot., datë 2.12.2021, dhe nr. 1119/1 prot., datë 17.12.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik i digës së Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5143 kwp.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "KESH" sh.a., rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c", plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "f", "g", plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "d", plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3, germat: "a", "b", "c", "d", dhe pika 4.4.4, germat: "a", "b", "c", plotësuar;
- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, germat "a" dhe "b", plotësuar.
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "c" (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakti historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)), plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;
- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, me data të rifreskuara, vërtetimin e gjykatës për shoqërinë dhe vërtetimet e prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin, në zbatim të nenit 8, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ajo duhet të paraqesë edhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për administratorin e shoqërisë, i cili mungon;

- germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik-elektrik, plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE licencën për drejtuesit teknik-elektrik;

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit te Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me data të rifreskuara, në zbatim të nenit 8, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

Nga ky dokumentacion rezulton se shoqëria "KESH" sh.a., në kohën kur është pajisur me këto vërtetime ka rezultuar debitore ndaj pagesave të gjobave, duhet të informojë ERE-n nëse i ka shlyer këto debi në vijim;

- germa "b" (bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose i kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortak të tjerë paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria KESH sh.a. duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020;

- germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.)), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare, në kuptim të kësaj pike të rregullores;

- dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4:

- germa "d" (plani i biznesit), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria ka depozituar në ERE programin ekonomiko-financiar të saj për periudhën 5-vjeçare 2021–2025. Ky program është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë me vendimin nr. 22, datë 17.12.2020, dhe bashkëlidhur tij gjendet edhe lista e investimeve të parashikuara nga KESH sh.a. për vitet 2021–2025, por konstatojmë se tabela është në një format të vogël, çka e bën të pa lexueshme.

Për këtë arsye, shoqëria duhet të depozitojë në ERE tabelën e investimeve në format të lexueshëm për të parë nëse përfshihet edhe centrali fotovoltaik i digës së Qyrsaqit, dhe si është llogaritur investimi për të, do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë ato brenda afateve.

- Në formatin e aplikimit shoqëria KESH sh.a. ka deklaruar si vit ndërtimi vitin 2021 dhe fillim operimi datën 14.2.2022, vlerësohet që në vijim t'i kërkohet shoqërisë informacion, në lidhje me fillimin apo me fazën në të cilën ndodhen punimet e centralit fotovoltaik.

- Shoqëria duhet të përcjellë informacion edhe në lidhje me pajisjen me leje ndërtimi, në mënyrë që të llogaritet edhe vlefshmëria e lejes mjedisore, duke konsideruar afatin 2-vjeçar që parashikon ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar.

- Ndërtimi i projektit të centralit gjenerues të energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike) është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 8.7.2021, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe të veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.)".

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltaik të digës së Qyrsaqit rezulton se jetëgjatësia e një paneli

shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, deri në 25 vjet.

- Në kuadër të përcaktimeve të studimit të fizibilitetit për jetëgjatësinë e moduleve fotovoltaike, ku në rastin konkret rezulton 25 vjet, do të diskutohet me shoqërinë "KESH" sh.a. kushtëzimi që kjo jetëgjatësi mund të ketë në afatin e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "KESH" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik i digës së Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 mwp, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti